



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 7 tetor 2021

Nr. ref.:AGJ 1865/21

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO61/21

Parashtrues

Slavko Simić dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 08/V-005, të 22 marsit 2021, për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Slavko Simić, Zoran Mojsilović, Miljana Nikolić, Ivan Todosijević, Verica Čeranić, Branislav Nikolić, Jasmina Dedić, Ljubinko Karadžić, Miloš Perović, Adem Hodža dhe Igor Simić (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), të gjithë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi).

2. Parashtruesit e kërkesës kanë autorizuar deputetin e Kuvendit, Igor Simić, që t'i përfaqësojë ata në procedurat para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).

Akti i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit të Kuvendit nr. 08/V-005, të 22 marsit 2021, për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: vendimi i kontestuar).

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet se nuk është në pajtueshmëri me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta).
5. Parashtruesit e kërkesës më tej kërkojnë nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme *“me të cilën do ta vendoste në gjendje qetësie pozitive të ministrit i cili u emërua Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal - Elbert Krasniqi sepse nuk e ka mbështetur e (11) njëmbëdhjetë deputetëve që përbën shumicën e (20) njëzet deputetëve të cilët përfaqësojnë komunitetet jo shumicë”*.
6. Parashtruesit e kërkesës po ashtu kërkojnë që Gjykata *“në pajtim me nenin 24 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe nenin 42 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese, të mbajë një dëgjim publik në të cilin do të ftohej të gjithë deputetët që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kosovë (komuniteti Serb jo shumicë prej (10) dhjetë deputetëve dhe të komuniteteve tjera jo shumicë (10) dhjetë deputetë) [...]”*.

Baza juridike

7. Kërkesa bazohet në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, nenet 27 [Masat e përkohshme], 42 [Saktësimi i kërkesës] dhe 43 [Afatet], të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), si dhe në rregullat 56 [Kërkesa për masë të përkohshme], 74 [Kërkesa në pajtim me nenin 113. 5 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit], të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

8. Më 29 mars 2021, parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesën e tyre në Gjykatë.
9. Në të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi, gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (anëtarë).

10. Më 30 mars 2021, parashtruesit e kërkesës u njoftuan për regjistrimin e kërkesës.
11. Po të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua Ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës z. Glauk Konjufca (në tekstin e mëtejshëm: U.d. Presidenti), Kryeministrit të Republikës së Kosovës z. Albin Kurti (në tekstin e mëtejshëm: Kryeministri) dhe Avokatit të Popullit, me udhëzimin që t'i dorëzojnë Gjykatës komentet, nëse kanë, deri më 14 prill 2021. Kërkesa po ashtu iu komunikua edhe Kryetarit të Kuvendit z. Glauk Konjufca, të cilit iu kërkuar që të njoftojë deputetët e Kuvendit se mund të dorëzojnë komentet e tyre në lidhje me kërkesën e parashtruesve të kërkesës, nëse kanë, deri më 14 prill 2021.
12. Më 30 mars 2021, Gjykata po ashtu kërkoj nga Sekretariati i Kuvendit që deri me datë 14 prill 2021, t'ia dorëzojë Gjykatës të gjitha dokumentet relevante për vendimin e kontestuar.
13. Më 2 prill 2021, Sekretariati i Kuvendit i dorëzoi Gjykatës dokumentet relevante lidhur me vendimin e kontestuar, dhe atë:
 - Dekretin nr. 61/2021, të datës 22 marsit, të u.d Presidentit;
 - Kërkesën e 52 deputetëve të Kuvendit për thirrjen e Seancës së jashtëzakonshme për votimin e Qeverisë: Do-08/13, të 22 marsit 2021;
 - Ftesat për mbajtjen e Seancës së Jashtëzakonshme të Kuvendit të 22 marsit 2021;
 - Vendimin e Kuvendit nr. 08-V -005, të 22 marsit 2021; dhe,
 - Transkriptin e Mbledhjes (Seancës) së Jashtëzakonshme të Kuvendit, të 22 marsit 2021.
14. Më 14 prill 2021, Kryeministri në emër të Qeverisë dorëzoi komente lidhur me kërkesën.
15. Më 20 prill 2021, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës, Presidenten znj. Vjosa Osmani, Kryetarin e Kuvendit, dhe Avokatin e Popullit, lidhur me komentet e Kryeministrit dhe dokumentet e pranuar nga Sekretariati i Kuvendit. Gjykata po ashtu njoftoi Kryeministrin lidhur me dokumentet e pranuar nga Sekretariati i Kuvendit.
16. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21 u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
17. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

18. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit KSH61/21, emëroi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci si anëtare të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu.
19. Më 24 qershor 2021, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Gjykatë shkresën *"Plotësim i kërkesës KO 61-21"*. Në këtë shkresë, parashtruesit e kërkesës theksuan se *"Me këtë parashtrësë dëshirojmë të plotësojmë kërkesën dhe të njoftojmë Gjykatën Kushtetuese se përveç shkeljeve të cilat i kemi theksuar në kërkesën tonë të parë të regjistruar në Gjykatë me numër KO 61-21, tashmë 90 ditë ekziston edhe një shkelje e vazhdueshme e nenit 96 paragrafi 4, pasi që në Qeveri nuk është emëruar asnjë zëvendësministër para komunitetit Serb, siç parashihet në nenin 96 paragrafi 4 [të Kushtetutës]"*.
20. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani morri detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
21. Më 28 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Gresa Caka-Nimani, nxori Vendimin KSH61/21, duke e zëvendësuar Kryetaren paraprake, Arta Rama-Hajrizi, në rolin e saj si kryesuese në Kolegjin shqyrtues.
22. Më 28 korrik 2021, Gjykata shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe vendosi që rasti të shqyrtohet sërish në një seancë të ardhshme. Gjykata gjithashtu vendosi se nuk mund të shqyrtojë pretendimet e reja në kuadër të kërkesës KO61/21, e cila tanimë është duke u shqyrtuar nga ajo. Rrjedhimisht, më 3 gusht 2021, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës se në përputhje me rregullat 33 (Regjistrimi i kërkesës dhe afati i dorëzimit), 34 (Përmirësimi i kërkesave dhe përgjigjeve) dhe 38 (Kolegjet shqyrtuese) të Rregullores së punës, pretendimet e paraqitura në shkresën për *"plotësimin e kërkesës KO 61-21"* të dorëzuara me 24 qershor 2021, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata përmes kërkesës KO61/21.
23. Më 22 shtator 2021, Gjykata shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.
24. Më 24 shtator 2021, Gjykata vendosi (i) njëzëri, se kërkesa është e pranueshme; (ii) me shumicë votash, se vendimi i kontestuar është në pajtueshmëri me Kushtetutën; (iii) njëzëri, refuzoi kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme; dhe (iv) me shumicë votash, refuzoi kërkesën për mbajtjen e seancës dëgjimore.

Përmbledhja e fakteve

25. Më 6 janar 2021, U.d Presidentja znj. Vjosa Osmani, nxori Vendimin nr.02/2021, për caktimin dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend, të cilat u caktuan për 14 shkurt 2021.
26. Më 14 shkurt 2021, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme për Kuvend.
27. Më 13 mars 2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejme: KQZ) certifikoi rezultatet e zgjedhjeve për Kuvend të 14 shkurtit 2021, përmes Vendimit nr.950/2021, sipas listës vijuese të rezultateve të zgjedhjeve:
 - a. Lëvizja VETËVENDOSJE! (në tekstin e mëtejme LVV), 58 deputetë;
 - b. Partia Demokratike e Kosovës - PDK, 19 deputetë;
 - c. Lidhja Demokratike e Kosovës - LDK, 15 deputetë;
 - d. Srpska Lista, 10 deputetë;
 - e. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës -AAK, 8 deputetë;
 - f. Kosova Demokratik Turk Partisi - KDTP, 2 deputetë;
 - g. Koalicija "Vakat", 1 deputet;
 - h. Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, 1 deputet;
 - i. Romani Iniciativa – RI, 1 deputet;
 - j. Nova Demokratska Stranka - NDS, 1 deputet;
 - k. Socialdemokratska Unija –SDU, 1 deputet;
 - l. Jedinstvena Goranska Partija, 1 deputet;
 - m. Partia e Ashkalinjëve për Integrim, 1 deputet;
 - n. Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës - LPRK, 1 deputet.
28. Më 16 mars 2021, në vazhden e takimeve me partitë politike që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kuvend, u mbajt një takim në mes të përfaqësuesve të LVV-së dhe atyre të Listës Serbe.
29. Më 21 mars 2021, z. Albin Kurti, në cilësinë e tij si Kryetar i LVV-së, i kishte dërguar një letër z.Goran Rakić, në cilësinë e këtij të fundit si Kryetar i Listës Serbe, duke theksuar se: *"[...] në pajtim me nenin 96, par. 3 dhe 4 [të Kushtetutës], në lidhje me nenin 92 par. 1 dhe 2, në cilësinë e Kryetarit të partisë fituese dhe Kryeministrit të ardhshëm të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 95 par. 3 dhe 4 [të Kushtetutës], ju ftoj juve- Listën Serbe, të propozoni emrat e tre deputetëve të partisë suaj, nga të cilët unë do të zgjedh një Ministër të Ministrisë së Komuniteteve dhe Kthimit [...]".*
30. Po atë ditë, pra më 21 mars 2021, z.Goran Rakić, në cilësinë e tij si Kryetar i Listës Serbe, i dërgoi një shkresë z. Albin Kurti në cilësinë e këtij të fundit si Kryetar i LVV-së, në përgjigje të shkresës së lartcekur, duke theksuar si në vijim: *"[...] në rast se propozoni një Qeveri me 12 ministra, ne do të japim emrin e një ministri.*

Në rast se ju propozoni një Qeveri me më shumë se 12 ministri, dua të ju informoj se në pajtim me nenin 96, paragrafët 3, 4 dhe 5, ju jeni të obliguar të caktoni 3 ministri në administrim të komuniteteve jo shumicë në Kosovë.

Në lidhje me këtë, dëshiroj të ju informoj se grupi parlamentar i Listës Serbe në legjislaturën e re do të ketë 11 deputetë (10 nga Lista Serbe dhe 1 nga Partia Unike Gorane), që përfaqëson shumicën e numrit të përgjithshëm prej (20) deputetëve në Kuvendin e Kosovës, të cilët përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në pajtim me nenin 96, paragrafët 3, 4 dhe 5.

Pra, nëse qeveria e ardhshme ka më shumë se 12 ministri, nesër ne do t'ju sigurojmë 2 emra për ministra që nuk janë nga radhët e deputetëve, por në pajtim me Kushtetutën kanë mbështetjen e 11 deputetëve që mbajnë vende të destinuara për komunitetet jo shumicë.[...].”

31. Më 22 mars 2021, u mbajt mbledhja konstituive e Kuvendit, me tri pika të rendit të ditës:
 1. Formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve;
 2. Dhënia e betimit të deputetëve;
 3. Zgjedhja e Kryetarit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit.
32. Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve, në të njëjtën ditë paraqiti Raportin para Kuvendit. Pas kësaj, deputetët dhanë betimin si dhe me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve u konstituua Kuvendi.
33. Po atë ditë, U.d Presidenti nxori Dekretin Nr.61/2021 me të cilin *“Z. Albin Kurti i propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës”*.
34. Më 22 mars 2021, 52 (pesëdhjetë e dy) deputetë të Kuvendit paraqitën kërkesë për mbajtjen e Seancës së Jashtëzakonshme për votimin e Qeverisë.
35. Po atë ditë, pra më 22 mars 2021, z. Albin Kurti, në cilësinë e tij si Kryetar i LVV-së dhe si Mandatar për Kryeministër, i kishte dërguar një letër z.Goran Rakić, në cilësinë e Kryetarit të Listës Serbe, duke theksuar, mes tjerash, si në vijim *“në cilësinë e kryetarit të partisë fituese dhe mandatarit për Kryeministër për formimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 95, paragrafët 3 dhe 4, ju ftoj juve - Listën Serbe të propozoni emrat e tre deputetëve të partisë tuaj, nga të cilët unë do të zgjedh një për Ministër të Ministrisë së Komuniteteve dhe Kthimit [...]”*.
36. Në të njëjtën ditë, z.Goran Rakić, në cilësinë e tij si Kryetar i Listës Serbe, i dërgoi një shkresë z. Albin Kurti në cilësinë e këtij të fundit si Kryetar i LVV-së dhe Mandatar për formimin e Qeverisë, duke theksuar si në vijim: *“[...] Duke pasur parasysh që ju propozoni një Qeveri me më shumë se 12 ministri, në pajtim me nenin 96 par. 3, 4 dhe 5 ju jeni të obliguar të ndani tri ministri në administrim të komuniteteve jo shumicë në Kosovë. Në lidhje me këtë, ne dëshirojmë t'ju informojmë se 11 deputetë (10 nga Lista Serbe dhe një nga Partia Unike Gorane) që përfaqëson shumicën e numrit të përgjithshëm (20) deputetëve që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kuvendin e Kosovës, në pajtim me nenin 96, paragrafët 3, 4 dhe 5 të Kushtetutës së Kosovës ju japin emrin e kandidatit për ministrin e tretë.*

*Ai është:
Dalibor Jevtic [...]”.*

37. Po atë ditë, pra më 22 mars 2021, Kuvendi mbajti mbledhjen e jashtëzakonshme të thirrur nga 52 deputetë të Kuvendit, me rend të ditës, Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me ç’rast i mandatuari për Kryeministër z. Albani Kurti, paraqiti përbërjen e Qeverisë, si në vijim:
1. Albin Kurti, Kryeministër;
 2. Besnik Bislimi, Zëvendëskryeministër i parë për integritet evropian, zhvillim dhe dialog;
 3. Donika Gërvalla, Zëvendëskryeministër e dytë dhe Ministër e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
 4. Emilija Redžepi, Zëvendëskryeministër e tretë për çështje të pakicave dhe të drejtat e njeriut (përfaqësues nga komunitetet tjera jo shumicë në Kuvend);
 5. Hekuran Murati, Ministër i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
 6. Albulena Haxhiu, Ministër e Ministrisë së Drejtësisë;
 7. Armend Mehaj, Ministër i Ministrisë së Mbrojtjes;
 8. Xhelal Sveçla, Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike;
 9. Arben Vitia, Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë;
 10. Arbërie Nagavci, ministër e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
 11. Hajrulla Çeko, Ministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
 12. Elbert Krasniqi, ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (përfaqësues nga komunitetet e tjera jo shumicë në Kuvend);
 13. Liburn Aliu, Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
 14. Faton Peci, Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
 15. Rozeta Hajdari, Ministër e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
 16. Artane Rizvanolli, Ministër e Ministrisë së Ekonomisë;
 17. Goran Rakić, Ministër i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (i votuar nga deputetët jo shumicë që përfaqësojnë komunitetin Serb në Kuvend);
 18. Fikrim Damka, Ministër i Ministrisë për Zhvillim Rajonal (përfaqësues nga komunitetet e tjera jo shumicë në Kuvend).
38. Ashtu si u theksua më lart, lidhur me z.Goran Rakić, i propozuar për pozitën e ministrit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim nga përfaqësuesit e komunitetit Serb në Kuvendit e Kosovës, pasi i njëjti nuk ishte deputet i Kuvendit, konform paragrafit 5 të nenit 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve], u votua ndaras nga deputetët e komuniteti Serb, me ç’rast ai propozim mori 10 nga 10 votat e deputetëve që përfaqësojnë komunitetin Serb në Kuvendin e Kosovës.
39. Po atë ditë, pra më 22 mars 2021, përmes vendimit të kontestuar, nr. 08/V-005, Kuvendi zgjodhi Qeverinë e Republikës së Kosovës, me 67 vota “për”, 30 “kundër” dhe asnjë “abstenim”, sipas përbërjes së propozuar të cekur më lart.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

40. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se vendimi i kontestuar nuk është në pajtim me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës.
41. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se neni 96 i Kushtetutës parasheh që në Qeveri duhet të jetë së paku *“një (1) ministër nga komuniteti Serb dhe një (1) ministër nga ndonjë komunitet tjetër jo shumicë në Kosovë. Nëse janë më shumë se dymbëdhjetë ministra, Qeveria do të ketë edhe një ministër të tretë, i cili përfaqëson një nga komunitetet jo shumicë në Kosovë.”*
42. Lidhur me këtë ata shtojnë se *“sipas nenit 96 par. 3 rezervimi i vendit për të paktën (2) dy ministra të komuniteteve jo shumicë por nuk përjashton mundësinë që Qeveria të ketë më shumë se dy ministra të tillë. Megjithatë, sipas detyrimeve sipas këtij neni, të paktën (2) dy ministra nga komunitetet jo shumicë në Kosovë duhet të jenë pjesë e Qeverisë. Përfaqësimi i rezervuar i komuniteteve jo shumicë në Qeveri përbën të ashtuquajturin parim „të qeverisë së gjerë“ në kuptim të multietnicitetit, dhe është një kusht kryesor i demokracisë konsociacionale („consociational democracy“). Ky model i strukturës së Qeverisë mundëson që karakteri i garantuar multietnik i shtetit shprehet jo vetëm për përfaqësim të rezervuar në qeveri, por edhe sepse ministrat që rezultojnë nga ky nen i Kushtetutës përfaqësojnë zërin e komuniteteve të tyre në procesin e krijimit të politikave qeveritare.”* Lidhur me këtë ata i referohen Komentarit, Kushtetuta e Republikës së Kosovës *Hasani, Enver dhe Čukalović, Ivan, (2013) GIZ, Prishtinë* (në tekstin e mëtejme: Komentari i Kushtetutës).
43. Duke iu referuar sërish Komentarit të Kushtetutës ata shtojnë se *“emërimi i ministrave dhe zëvendësministrave nga komunitetet jo shumicë në pajtim me nenin 96.4 do të bëhet pas konsultimit me partitë, koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kosovë. Nëse emërohen kandidatët nga jashtë strukturës së deputetëve të Kuvendit të Kosovës, për emërimin e tyre kërkohen votat e shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët janë anëtarë të partive, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur të cilët kanë deklaruar se do të përfaqësojnë komunitetin në fjalë. [...] Nga pikëpamja ligjore, termi “konsultim” i përdorur në këtë nen i referohet procedurës kur partia/koalicioni që përfaqëson komunitetin në fjalë në Kuvendin e Kosovës jep kandidaturën e saj për përbërjen e Qeverisë që vendos kandidatin për Kryeministër. Pranimi i kandidatit të propozuar nga partia/koalicioni që përfaqëson komunitetin përkatës jo shumicë është i detyruar brenda kuptimit të nenit 96.5, në të kundërtën, do të konsiderohej që nuk është përmbushur detyrimi për konsultim të plotë me partinë/koalicionin në pajtim me këtë nen. Kjo do të thotë që ky nen e imponon një lloj koalicioni parlamentar, madje edhe në mënyrë të nënkuptuar, midis partive/koalicioneve që synon të formojë Qeverinë dhe deputetët e komuniteteve jo shumicë, pasi që pranimi i kandidatit të tyre në përbërjen e qeverisë është një detyrim sipas nenit në fjalë. Ky lloj koalicioni, edhe në mënyrë implicite, rezulton në një koalicion parlamentar multietnik, e cila është mënyra e vetme për të zbatuar dispozitat që dalin nga ky nen [neni 96 i Kushtetutës]”.*

44. Lidhur me ministrinë e tretë nga radhët e komuniteteve jo shumicë, parashtruesit e kërkesës theksojnë se “Kushtetuta nuk përcakton qartë këtu nëse ky ministër vjen nga radhët e komuniteteve jo shumicë serbe apo nga komunitetet e tjera jo shumicë. Por neni 96 paragrafi 5 përcakton që ministrat që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë duhet të emërohen “pas konsultimit me partitë, me koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë”.
45. Andaj, ata shtojnë se “[...] është e qartë se as këtu dhe as në rastet e mëparshme të përfaqësimit të pakicave Kushtetuta nuk e la mundësinë që mandatarit ose Kryeministri të kenë lirinë e zgjedhjes, por me Kushtetutë kërkohej konsultime për të siguruar një përfaqësim reprezentues të komuniteteve jo shumicë në konsultim me partitë, koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kosovë.” Andaj, ata shtojnë pyetjen “se si të vihet deri te një përfaqësim reprezentues të komuniteteve jo shumicë në rastin kur Kushtetuta nuk përcakton qartë se nga cili komunitet vjen ministri i tretë si në dy rastet e mëparshme”.
46. Ata mbajnë qëndrimin se “[...] nëse ministri që përfaqëson komunitetin Serb emërohet nga shumica prej (10) dhjetë deputetëve që përfaqësojnë komunitetin Serb, dhe nëse ministri nga komunitetet e tjera jo shumicë emërohet me shumicën e (10) dhjetë deputetëve që përfaqësojnë komunitetet tjera jo shumicë, atëherë është plotësisht logjike që ministri i (3) tretë i emëruar nga komunitetet jo shumicë të emërohet nga një shumicë prej (20) njëzet deputetëve të cilët, në pajtim me nenin 64 të Kushtetutës, përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kosovë (komuniteti Serb jo shumicë (10) deputetë dhe komunitetet e tjera jo shumicë prej (10) dhjetë deputetëve). [...] Që do të thotë se Kryeministri është i detyruar të mbajë konsultime dhe si ministër i tretë që përfaqëson komunitetet jo shumicë në Kosovë emëron një përfaqësues të komuniteteve jo shumicë (qoftë nga komuniteti Serb jo shumicë ose nga komunitetet e tjera jo shumicë) në Kosovë i cili arrin të sigurojë mbështetjen e shumicës prej (20) njëzet deputetëve që përbëjnë shumicën e komuniteteve, përkatësisht (11) njëmbëdhjetë nga gjithsej (20) njëzet deputetë të cilët, në pajtim me nenin 64 të Kushtetutës, përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kosovë (komuniteti Serb jo shumicë (10) dhjetë deputetë dhe komunitetet tjera jo - shumicë (10) dhjetë deputetë)”.
47. Duke u bazuar në argumentet e lartcekura, parashtruesit e kërkesës shtojnë se “ministri i tretë është Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal – Elbert Krasniqi i cili u emërua pa konsultim si përfaqësues i komunitetit jo shumicë në kundërshtim me nenin 96 të Kushtetutës sepse nuk siguroi mbështetjen e (11) njëmbëdhjetë deputetëve nga gjithsej (20) njëzet deputetë të cilët, në pajtim me nenin 64 të Kushtetutës, përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kosovë (komuniteti Serb jo shumicë (10) dhjetë deputetë dhe komunitetet tjera jo shumicë (10) dhjetë deputetë). Andaj, në rastin konkret ata konsiderojnë se “të drejtat e komuniteteve jo shumicë në përgjithësi dhe të komunitetit Serb në veçanti janë marginalizuar dhe në mënyrën më të vrazhdë anashkalon shkronjën dhe frymën e Kushtetutës duke caktuar Ministër të Administratës së Vetëqeverisjes Lokale - Elbert Krasniqin i cili në legjislaturën e fundit madje

nuk ishte pjesë e grupit parlamentar të komuniteteve jo shumicë por ishte pjesë e grupit parlamentar të subjektit politik të Lëvizjes Vetëvendosje”.

48. Andaj, ata theksojnë se “[k]onsiderojmë se Kryeministri është dashur, në pajtim me nenin 96, të thërrasë konsultime me të gjitha komunitetet jo shumicë dhe të emërojë si ministër të tretë në përputhje me nenin 96 paragrafi 3 atë përfaqësues të komuniteteve jo shumicë që arrin të sigurojë (11) njëmbëdhjetë vota të deputetëve, përkatësisht, shumicën e votave nga (20) njëzet vota në këshillin e komuniteteve, i cili pikërisht për këtë edhe ekziston që të shprehë pikëpamjet e komuniteteve jo shumicë”.
49. Duke bërë krahasime me pozitat e tjera të komuniteteve jo shumicë në Kuvend apo që emërohen nga Kuvendi, ata theksojnë se “[...] pothuajse të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë emërohen në këtë mënyrë, për shembull (nënkryetari i Kuvendit para komunitetit Serb), është logjike që me 10 vota serbe ai kurrë nuk mund të marrë 61 votë sa i duhet të emërohet nënkryetar i Kuvendit të Kosovës, por kjo nuk do të thotë që Kryetari i Kuvendit mund t’i imponojë komunitetit Serb se cili nga deputetët Serbë do të jetë nënkryetar i Kuvendit. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese emërohen në mënyrë të ngjashme, ku për dy gjyqtarë kërkohet së pari votim në këshillin e komunitetit dhe vetëm pasi të marrin miratimin nga deputetët e komunitetit jo shumicë do të votohen në kuvend në legjislaturën e plotë. [...] Me norma të tilla, kushtetutbërësi dëshironte të mbronte të drejtat e komuniteteve jo shumicë, në mënyrë që shumica të mos i mbivotonte dhe marginalizonte, që pikërisht është bërë gjatë zgjedhjes së qeverisë”.
50. Andaj, parashtruesit e kërkesës kërkojnë që Gjykata: i) të shpallë kërkesën të pranueshme; ii) të konstatojë që vendimi i kontestuar nuk është në pajtueshmëri me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës; si dhe iii) të urdhërojë Kryeministrin që në pajtim me nenin 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] i Kushtetutës, të kryejë riorganizimin e Qeverisë dhe të emërojë si ministër të tretë nga komunitetet jo shumicë një person që i përket komuniteteve jo shumicë të propozuar dhe mbështetur nga një shumicë e thjeshtë prej (11) njëmbëdhjetë deputetësh nga gjithsej (20) njëzet deputetë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kuvend.

Kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme

51. Parashtruesit e kërkesës lidhur me kërkesën për masë të përkohshme, arsyetojnë se janë plotësuar kushtet e parapara në paragrafin (4) të rregullit 57 të Rregullores së punës për nxjerrjen e masës së përkohshme, pasi në rastin konkret kemi një “*rast prima facie për meritat e kërkesës*” sepse rasti është paraqitur nga (11) njëmbëdhjetë deputetë brenda (8) tetë ditësh dhe në përputhje me nenin 113 paragrafi 5, rasti është qartazi i pranueshëm në merita”.
52. Ata shtojnë se “[...] për sa i përket vetë dëmit të pariparueshëm, është e qartë se kemi një përfaqësim jo-reprezentues të komuniteteve jo shumicë në Kuvendin e Kosovës ku një person përfaqëson komunitetet jo shumicë edhe pse nuk ka mbështetjen e (11) njëmbëdhjetë deputetëve që përbën shumicën e (20) njëzet

deputetëve që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë, me ç'rast shumica në komunitetet jo shumicë pëson dëme të pariparueshme sepse ato i përfaqëson një person i paautorizuar i cili nuk është përfaqësues reprezentues i komuniteteve jo shumicë”.

53. Gjithashtu, sa i përket kriterit se masa e përkohshme duhet të jetë në interes publik ata arsyetojnë se *“Qeveria e Kosovës aktualisht është në përbërje antikushtetuese sepse në përbërjen e saj ulet një person që nuk ka autoritetin e deputetit të komuniteteve jo shumicë për të përfaqësuar komunitetet jo shumicë. Është në interesin publik që Qeveria të themelohet në përbërje Kushtetuese dhe që Qeveria të punon dhe funksionon në pajtim me Kushtetutën. Për shkak se në këtë moment nuk është ky rasti, është në interesin publik të vendoset një masë e përkohshme me të cilën do ta vendoste në gjendje qetësie pozitive të ministrit i cili u emërua Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal - Elbert Krasniqi sepse nuk e ka mbështetjen e (11) njëmbëdhjetë deputetëve që përbëjnë shumicën e (20) njëzet deputetëve të cilët përfaqësojnë komunitetet jo shumicë”.*

Kërkesa për mbajtje të seancës dëgjimore publike

54. Parashtruesit e kërkesës po ashtu kërkojnë nga Gjykata mbajtjen e seancës dëgjimore në të cilin kjo e fundit do të ftohet të gjithë deputetët që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kosovë që të përcaktojnë çështjet në vijim:
- cili përfaqësues i komunitetit Serb ka mbështetjen e shumicës prej 10 (dhjetë) deputetëve që përfaqësojnë komunitetin Serb në mënyrë që të emërohet ministër;
 - cili përfaqësues i komuniteteve të tjera jo shumicë ka mbështetjen e shumicës prej (10) dhjetë deputetëve përfaqësues të komuniteteve të tjera jo shumicë, në mënyrë që të emërohet ministër;
 - cili përfaqësues i të gjitha komuniteteve jo shumicë ka mbështetjen e shumicës ose (11) njëmbëdhjetë nga gjithsej (20) njëzet deputetë për tu emëruar ministër i tretë i komuniteteve jo shumicë nëse Qeveria i ka më tepër se 12 (dymbëdhjetë) ministri;
 - të përcaktohet se ministri i tretë para komuniteteve jo shumicë i cili është emëruar Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal - Elbert Krasniqi, i cili është përfaqësues i të gjitha komuniteteve jo shumicë, nuk ka pasur mbështetjen e shumicës së thjeshtë prej (11) njëmbëdhjetë nga gjithsej 20 njëzet deputetë të cilët sipas nenit 64 të Kushtetutës përfaqësojnë komunitetet jo shumicë.

Komentet e Kryeministrit, z. Albin Kurti, të dorëzuara në emër të Qeverisë

55. Kryeministri theksoi se lidhur me kërkesën e paraqitur në Gjykatë, parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, kanë ushtruar të drejtën e tyre brenda afatit kushtetues, kanë informuar Gjykatën në lidhje me dispozitat kushtetuese të cilat kanë relevancë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar, mirëpo kanë dështuar të ofrojnë prova në lidhje me pretendimet e tyre. Në këtë kontekst, Kryeministri theksoi se *“Qeveria e konsideron të nevojshme që pavarësisht faktit se kërkesa*

nuk mbështetet në prova dhe nuk arsyeton pretendimin e parashtruesve për pakushtetutshmërinë e vendimit të kontestuar (qartazi e pabazuar në baza kushtetuese), me qellim që procedura e zgjedhjes dhe emërimit të përfaqësuesve të pakicave në kuadër të Qeverisë së Kosovës të konsiderohet e gjykuar nga Gjykata Kushtetuese, Qeveria e konsideron të nevojshme dhe në interes të stabilitetit kushtetues që Gjykata të shpallë të pranueshme kërkesën dhe të vendos në merita të rastit. Sepse një çështje konsiderohet "res judicata" vetëm kur ajo gjykohet përmes një aktgjykimi dhe jo nëse për shkak të mungesës së arsytimit shpallet e papranueshme proceduralisht".

56. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se me rastin e zgjedhjes së Qeverisë janë shkelur paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 të Kushtetutës, Kryeministri thekson se *"parashtruesit kanë keqinterpretuar paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 të Kushtetutës, sepse kandidati për kryeministër i ka përmbushur detyrimet kushtetuese të parapara me këtë Kushtetutë"*. Pasi Kushtetuta në paragrafin 3 të nenit 96 përcakton se të paktën një (1) ministër nga komuniteti Serb, dhe një (1) ministër nga komunitetet e tjera pakicë, duhet të përfaqësohen në Qeveri, sipas paragrafit 3 të nenit 96 të Kushtetutës, nëse janë më shumë se dymbëdhjetë ministra, Qeveria do të ketë edhe një ministër të tretë, i cili përfaqëson një nga komunitetet joshumicë në Kosovë. Megjithatë, sipas Kryeministrit *"Kushtetuta nuk përcakton se ministri i tretë i cili përfaqëson komunitetet pakicë domosdoshmërisht duhet të jetë përfaqësues i komunitetit Serb. Kushtetuta në këtë rast është e qartë dhe përmban një formulim preciz, i cili nuk lë hapësirë për dykuptimësi"*. Lidhur me këtë ai thekson se *"komunitetet jo shumicë" nuk i referohet vetëm komunitetit Serb, por edhe komuniteteve të tjera jo shumicë që jetojnë në Republikën e Kosovës"*, duke shtuar se mbi bazën e kësaj ndahen edhe ulëset e garantuara sipas nenit 64.4 të Kushtetutës.
57. Lidhur me këtë, Kryeministri i referohet edhe ligjeve të tjera të cilat përcaktojnë përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë në institucione të tjera shtetërore të cilat i referohen përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë në përgjithësi pa përcaktuar kuotat për komunitetin Serb në veçanti. Në këtë aspekt, ai i referohet Ligjit për Avokatin e Popullit, Ligjit për Këshillin e Pavarur të Mediave, dhe Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil. Kryeministri argumenton se ligjet e lartcekura vërtetojnë se në momentin kur nuk specifikohet se nga i cili komunitet jo shumicë duhet të emërohet një anëtar, ajo nuk nënkupton se me automatizëm këta të emëruar duhet të jenë nga komuniteti Serb. Kjo dëshmohet nga praktika e deritanishme e funksionimit të këtyre institucioneve të pavarura, të cilat anëtarët e tyre i zgjedhin pas votimit të Kuvendit.
58. Kryeministri, lidhur me çështjen e konsultimit me partitë jo shumicë për caktimin e ministrave nga komunitetet jo shumicë thekson se para zgjedhjes së Qeverisë, *"parashtruesit e kërkesës konfirmojnë vet se më datën 21.03.2021 kanë pasur një letërkëmbim me kandidatin për kryeministër, ndërsa me datën 22.03.2021 janë takuar me të, pas mandatimit formal nga u.d. Presidenti. Rrjedhimisht është konsumuar detyrimi kushtetues i konsultimit me ta si përfaqësues të pakicës serbe në Kosove. Po ashtu, ata konfirmojnë se z. Goran Rakic është zgjedhur ministër sipas propozimit të grupit të tyre parlamentar."* Ai shton se *"[s]ikur të ishte shpërfillur propozimi i tyre dhe në vend të z. Rakic*

të ishte zgjedhur një person tjetër në pozitën e ministrit të garantuar për përfaqësuesit e pakicës serbe, atëherë pretendimi i parashtruesit do të kishte bazë. Mirëpo, të njëjtit nuk e kontestojnë zgjedhjen e z. Rakić”.

59. Në këtë kontekst, ai mban qëndrimin se “Konsultimi nuk është kategori e cila i jep të drejtën një pakice të caktuar që të diktojë përbërjen dhe ndarjen e ministrive në kuadër të Qeverisë. Mirëpo ai është një proces i cili i jep të drejtën përfaqësuesve të asaj pakice që të njoftojnë kandidatin për Kryeministër së cilët do të jenë përfaqësuesit e asaj pakice në kuadër të përfaqësimit të garantuar me Kushtetutë”.
60. Kryeministri shton se “Qeveria rithekson se Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet (neni 2.1 i Kushtetutës) dhe shoqëri shumëetnike e përberë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike (neni 3.1. i Kushtetutës). Në kuadër të kësaj demokracie, shumica shqiptare ka garantuar përfaqësimin e pakicave në kuadër të institucioneve të saj dhe përmes dispozitave të mësipërme kushtetuese ka garantuar karakterin unitar të rendit kushtetues dhe territorit të Republikës së Kosovës (neni 1 i Kushtetutës)”. Ai më tej thekson se në rastin konkret komunitetet jo shumicë janë konsultuar dhe në këtë aspekt janë respektuar procedurat kushtetuese për përfaqësimin e tyre në Qeveri.
61. Lidhur me kërkesën e parashtruesve të kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme, Kryeministri thekson se “Përveç mungesës së arsyeshmërisë për kërkesën për masë të përkohshme, vendosja e masës së përkohshme do të ishte në kundërshtim të plotë me interesin publik. Përmes masës së përkohshme, Qeveria konsideron që do të shkaktohej dëm i pariparueshëm, në një kohë kur vendit i duhet Qeveri funksionale në sigurimin e vaksinave për mbrojtje nga pandemia COVID-19 dhe në menaxhimin e përgjithshëm të pandemisë. Për më tepër, vendosja e masës së përkohshme do të ndikonte direkt edhe në mundësitë e Qeverisë për të punuar në procesin e rimëkëmbjes ekonomike si dhe do të rrezikonte edhe sigurinë kombëtare. Prandaj, një masë e përkohshme për rastin në fjalë nuk është në interesin publik, si dhe mund të shkaktoj dëm të pariparueshëm”. Kryeministri po ashtu thekson se nuk është e nevojshme as mbajtja e seancës dëgjimore pasi në rastin konkret nuk ka paqartësi në lidhje me çështjen e ligjit dhe faktit, prandaj kërkesa për seancë dëgjimore duhet të refuzohet.

Dispozitat relevante të Kushtetutës, ligjeve dhe akteve nënligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

“Neni 64 [Struktura e Kuvendit]

1. Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në

përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin.

2. *Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovës, si vijon:*

(1) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10);

(2) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti Rom një (1) vend; komuniteti Ashkali një (1) vend; komuniteti Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali, ose Egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti Boshnjak tri (3) vende, komuniteti Turk dy (2) vende dhe komuniteti Goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.

[...]

Neni 95 [Zgjedhja e Qeverisë]

1. *Pas zgjedhjeve, Presidenti i Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë.*
2. *Kandidati për Kryeministër, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit.*
3. *Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.*
4. *Nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda dhjetë (10) ditësh emëron kandidatin tjetër sipas së njëjtës procedurë. Nëse as herën e dytë nuk zgjidhet Qeveria, atëherë Presidenti i Kosovës i shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre.*
5. *Nëse Kryeministri jep dorëheqjen ose për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë, Qeveria bie, dhe Presidenti i Republikës së Kosovës, në*

konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri, për të formuar Qeverinë.

6. *Anëtarët e Qeverisë pas zgjedhjes, japin betimin para Kuvendit. Teksti i betimit rregullohet me ligj.*

Neni 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve]

1. *Ministritë dhe organet e tjera ekzekutive themelohen, sipas nevojës, për kryerjen e funksioneve brenda kompetencave të Qeverisë.*
2. *Numri i anëtarëve të Qeverisë përcaktohet me aktin e brendshëm të saj.*
3. *Në Qeveri do të jenë së paku një (1) Ministër nga komuniteti Serb dhe një (1) Ministër nga ndonjë komunitet tjetër jo shumicë në Kosovë. Nëse janë më shumë se dymbëdhjetë ministra, Qeveria do të ketë edhe një ministër të tretë, i cili përfaqëson një nga komunitetet jo shumicë në Kosovë.*
4. *Do të jenë së paku dy (2) zëvendësministra nga komuniteti Serb i Kosovës dhe dy (2) zëvendësministra nga komunitete të tjera jo shumicë në Kosovë. Nëse janë më shumë se dymbëdhjetë (12) ministra, Qeveria do të ketë edhe një zëvendësministër të tretë, i cili përfaqëson komunitetin Serb, dhe një (1) tjetër zëvendësministër, i cili përfaqëson një nga komunitetet e tjera jo shumicë në Kosovë.*
5. *Zgjedhja e këtyre ministrave dhe zëvendësministrave do të vendoset pas konsultimit me partitë, me koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë. Nëse caktohen kandidatë jashtë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, për këta ministra e zëvendësministra kërkohet miratimi formal i shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët u përkasin partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin në fjalë.*
6. *Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat e Qeverisë mund të zgjidhen nga deputetë të Kuvendit të Kosovës ose nga persona të kualifikuar, që nuk janë deputetë të Kuvendit.*
7. *Papajtueshmëria e anëtarëve të Qeverisë lidhur me funksionet e tyre rregullohet me ligj.”*

Pranueshmëria e kërkesës

62. *Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i plotëson kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj e me Rregullore të punës.*

63. Në këtë vazhdë, Gjykata i referohet paragrafit 1, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”

64. Përveç kësaj, Gjykata po ashtu i referohet nenit 113.5 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.”

65. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se kërkesa është paraqitur nga 11 (njëmbëdhjetë) deputetë të Kuvendit, në pajtueshmëri me nenin 113.5 të Kushtetutës. Prandaj, parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar për të paraqitur këtë kërkesë.

66. Në vijim, Gjykata merr parasysh nenin 42 [Saktësimi i kërkesës], të Ligjit, i cili përcakton se kërkesa e paraqitur sipas nenit 113.5 të Kushtetutës duhet të përmbajë:

“1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti.”

67. Gjykata, po ashtu, i referohet rregullit 74 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit], të Rregullores së punës, që parasheh:

“[...]

(2) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, duhet, inter alia, të paraqesë informatat e mëposhtme:

(a) emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e një ligji ose të një vendimi të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;

(b) dispozitat e Kushtetutës ose të aktit tjetër ose legjislacionit relevant për këtë kërkesë; dhe

(c) provat mbi të cilat mbështetet kontesti.

(3) Parashtruesit i bashkëngjisin kërkesës një kopje të ligjit të kontestuar ose vendimit të miratuar nga Kuvendi, regjistrin dhe nënshkrimet personale të deputetëve që paraqesin kërkesën dhe autorizimin e personit që i përfaqëson ata para Gjykatës.”

68. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës: (i) shënuan emrat e deputetëve dhe nënshkrimet e tyre; (ii) paraqitën autorizimin për personin që i përfaqëson ata

para Gjykatës; (iii) specifikuan vendimin që kontestojnë, konkretisht Vendimin e Kuvendit nr. 08/V-005, të 22 marsit 2021 për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe dorëzuan kopjen e tij; (iv) iu referuan dispozitave specifike kushtetuese, me të cilat ata pretendojnë se vendimi i kontestuar nuk është në pajtueshmëri; si dhe, (v) paraqitën prova dhe dëshmi për të mbështetur pretendimet e tyre.

69. Andaj, Gjykata konsideron se kriteret e përcaktuara me nenin 42 të Ligjit dhe të specifikuara më tej me rregullin 74 të Rregullores së punës janë plotësuar. Gjithashtu, për sa i përket afatit të përcaktuar për të paraqitur kërkesën, që është 8 (tetë) ditë nga data e miratimit të aktit të kontestuar, Gjykata vëren se vendimi i kontestuar është miratuar më 22 mars 2021, ndërsa kërkesa është parashtruar në Gjykatë më 29 mars 2021. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa u parashtrua brenda afatit kohor të përcaktuar me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës.
70. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj e me Rregullore të punës, dhe rrjedhimisht Gjykata e shpallë kërkesën të pranueshme dhe në vijim do të shqyrtojë meritat e saj.

Meritat e kërkesës

Përmbledhja e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës dhe argumenteve të Qeverisë

71. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar të 22 marsit 2021 të Kuvendit për zgjedhjen e Qeverisë, për të cilin perëndojnë se është në kundërshtim me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës.
72. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se sipas paragrafit 3 të nenit 96 të Kushtetutës, në Qeveri do të jenë së paku një (1) ministër nga komuniteti Serb dhe një (1) ministër nga ndonjë komunitet tjetër jo shumicë në Kosovë. Ndërsa, nëse janë më shumë se dymbëdhjetë ministra, Qeveria do të ketë edhe një ministër të tretë, i cili përfaqëson një nga komunitetet jo shumicë në Kosovë (në tekstin e mëtejme: ministri i “tretë”). Në këtë aspekt, ata konsiderojnë se duke pasur parasysh që caktimi i ministrave të komunitetit jo shumicë do të vendoset pas konsultimit me partitë, me koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë, emërimi i ministrit të “tretë”, duhet të propozohet dhe të ketë mbështetjen nga shumica e njëzet (20) deputetëve të Kuvendit që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kosovë. Andaj, argumentet e tyre për shkelje kushtetuese, parashtruesit e kërkesës i ndërtojnë duke theksuar se Qeveria e zgjedhur përmes vendimit të kontestuar, e që ka më shumë se dymbëdhjetë ministri, ministri i “tretë” i zgjedhur, përkatësisht Ministri Elbert Krasniqi, është zgjedhur në kundërshtim me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 të Kushtetutës. Kjo sipas tyre pasi që caktimi i tij në Qeveri, nuk është propozuar/miratuar nga shumica e njëzet (20) deputetëve të komuniteteve jo shumicë në Kosovë, ku përfshihen edhe deputetët e komuniteti Serb.

73. Përfundimisht, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se konform paragrafëve 3 dhe 5 të nenit 96 të Kushtetutës, për caktimin e ministrit të “tretë” në Qeveri, ka qenë i nevojshëm propozimi/miratimi nga shumica e të gjithë deputetëve që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kosovë, që në rastin konkret, nënkupton propozimin/miratimin nga të paktën njëmbëdhjetë (11) deputetë të këtyre komuniteteve nga njëzet (20) deputetë, sa janë gjithsej në legjislaturën aktuale të Kuvendit.
74. Lidhur me pretendimet e lartcekura të parashtruesve të kërkesës, Kryeministri, në emër të Qeverisë, thekson se Kushtetuta në paragrafin 3 të nenit 96 përcakton se të paktën një (1) ministër nga komuniteti Serb, dhe një (1) ministër nga komunitetet e tjera jo shumicë në Kosovë, duhet të përfaqësohen në Qeveri. Ndërsa, nëse janë më shumë se dymbëdhjetë ministra, Qeveria do të ketë edhe një ministër të tretë, i cili përfaqëson një nga komunitetet jo shumicë në Kosovë. Lidhur me këtë Kryeministri mban qëndrimin se Kushtetuta nuk përcakton se ministri i “tretë” i cili përfaqëson komunitetet pakicë domosdoshmërisht duhet të jetë përfaqësues i komunitetit Serb. Kjo pasi “komunitetet jo shumicë” nuk i referohet vetëm komunitetit Serb, por edhe komuniteteve të tjera jo shumicë që jetojnë në Republikën e Kosovës. Pasi Kushtetuta nuk specifikon se nga cili komunitet jo shumicë duhet të caktohet ministri i “tretë”, përderisa ai/ajo i përket njërit nga komunitetet jo shumicë në Kosovë, plotësohen kushtet për përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë në Qeveri ashtu siç është përcaktuar në nenin 96 të Kushtetutës. Andaj, sipas Kushtetutës nuk kërkohet që ministri i “tretë” të propozohet ose të ketë miratimin e shumicës së të gjithë deputetëve që përfaqësojnë komunitetin jo shumicë në Kuvend.
75. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës që i referohet kërkesës kushtetuese për “konsultim” me partitë jo shumicë për caktimin e ministrave nga komunitetet jo shumicë, Kryeministri pretendon se procesi i konsultimit nuk nënkupton se kjo i jep të drejtën një pakice të caktuar që të diktojë përbërjen dhe ndarjen e ministrive në kuadër të Qeverisë. Mirëpo, kërkesa për “konsultim” sipas nenit 96 të Kushtetutës është një proces i cili i jep të drejtën përfaqësuesve të asaj pakice që të njoftojnë kandidatin për Kryeministër së kush do të jenë përfaqësuesit e asaj pakice në kuadër të përfaqësimit të garantuar me Kushtetutë.
76. Prandaj, në dritën e këtyre pretendimeve të palëve, Gjykata fillimisht do të vlerësojë kriteret kushtetuese për përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë në Qeveri, përkatësisht: (i) nëse Kushtetuta e Kosovës, duke përfshirë paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 të Kushtetutës, parashohin që ministri i “tretë” i Qeverisë që përfaqëson komunitetet jo shumicë në Kosovë (në rast se Qeveria përbëhet nga më tepër se dymbëdhjetë (12) ministri) i takon ndonjë komuniteti të caktuar jo shumicë; (ii) të sqarojë nëse ministri i “tretë” duhet të propozohet dhe të marrë mbështetjen formale të shumicës së të gjithë deputetëve që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kosovë si dhe obligimet kushtetuese sa i përket konsultimeve me komunitetet jo shumicë për caktimin e ministrit të “tretë”; dhe (iii) do të vlerësojë nëse kriteret kushtetuese për caktimin e ministrit të “tretë” në Qeveri janë respektuar në rastin konkret.

(i) Nëse ministri i “tretë” i Qeverisë që përfaqëson komunitetet jo shumicë në Kosovë (në rast se Qeveria përbëhet nga më tepër se dymbëdhjetë (12) ministri) i takon ndonjë komuniteti të caktuar jo shumicë

77. Gjykata fillimisht e sheh të nevojshme të sqarojë se neni 64 [Struktura e Kuvendit] i Kushtetutës përcakton që nga njëqind e njëzetë (120) deputetë sa janë gjithsej në Kuvend, njëzet (20) prej tyre janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë në Kosovë.
78. Në kuadër të kësaj kuote të garantuar, partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10) (në tekstin e më tejme: deputetët që përfaqësojnë komunitetin Serb).
79. Ndërsa partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë në Kuvend, do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti Rom një (1) vend; komuniteti Ashkali një (1) vend; komuniteti Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali, ose Egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti Boshnjak tri (3) vende, komuniteti Turkydy (2) vende dhe komuniteti Goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara (në tekstin e mëtejme: deputetët që përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë në Kosovë).
80. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se neni 64 i Kushtetutës sa i përket njëzet vendeve të garantuara në Kuvend për komunitetet jo shumicë në Kosovë, bënë ndarjen në mes të: (i) deputetëve që përfaqësojnë “komunitetin Serb”, të cilët përfaqësohen në Kuvend me dhjetë (10) vende të garantuara; dhe (ii) deputetëve që përfaqësojnë “komunitetet e tjera jo shumicë”, dhe atë komunitetet: Rom, Ashkali, Egjiptian, Boshnjak, Turk dhe Goran, të cilët, së bashku, përfaqësohen në Kuvend me dhjetë (10) vende të garantuara, sipas ndarjes së përcaktuar mes tyre në nenin e lartcekur të Kushtetutës. Andaj, në vijim të këtij Aktgjykimi, Gjykata do t'i referohet kësaj ndarjeje në mes të komuniteteve jo shumicë në Kuvend.
81. Në vazhdim, lidhur me kërkesën e parashtruesve të kërkesës, Gjykata, do t'u referohet kritereve kushtetuese lidhur me zgjedhjen, përbërjen dhe përfaqësimin e komuniteteve në Qeveri, në veçanti kritereve dhe procedurës për caktimin e ministrit të “tretë” që përfaqëson komunitetet jo shumicë.
82. Gjykata vëren se kriteret lidhur me zgjedhjen, përbërjen dhe përfaqësimin e komuniteteve në Qeveri janë të përcaktuara në Kapitullin VI [Qeveria e Republikës së Kosovës] të Kushtetutës, që në nenet 92-101 të saj, mes tjerash, përcaktohen parimet e përgjithshme për Qeverinë, kompetencat e Qeverisë dhe të Kryeministrit, procedurat për zgjedhjen e Qeverisë, si dhe mënyrën e

përfaqësimit të komuniteteve në Qeveri. Gjykata, në vijim do elaborojë nenet 92 [Parimet e Përgjithshme], 95 [Zgjedhja e Qeverisë] dhe 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës, të cilat janë relevante për rastin konkret.

83. Në këtë aspekt, Gjykata së pari i referohet nenit 92 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës që përcakton se Qeveria ushtron pushtetin ekzekutiv dhe e cila përbëhet nga Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat.
84. Gjykata po ashtu i referohet nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës që përcakton mënyrën e zgjedhjes së Qeverisë. Më saktësisht, ashtu siç është sqaruar edhe në Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO72/20, paragrafi 1 i nenit 95 të Kushtetutës, përcakton që Presidenti i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë. Paragrafët 2 dhe 3, përcaktojnë që ky kandidat, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit. Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, përkatësisht votën e gjashtëdhjetë e një (61) deputetëve (shih në këtë kontekst, Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KO72/20, parashtrues: *Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykimit i 28 majit 2020, publikuar më 1 qershor 2020, paragrafi 428).
85. Megjithatë, Gjykata vëren se kriteret specifike për përbërjen e Qeverisë dhe përfaqësimin e komuniteteve, janë përcaktuar në nenin 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës. Neni 96 i Kushtetutës në paragrafët 1 dhe 2 përcakton se ministritë dhe organet e tjera ekzekutive themelohen për kryerjen e funksioneve brenda kompetencave të Qeverisë dhe se numri i anëtarëve të Qeverisë përcaktohet me aktin e brendshëm të saj. Ndërsa paragrafi 6 i nenit 96 të Kushtetutës parasheh që Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat e Qeverisë mund të zgjedhen nga radhët e deputetëve të Kuvendit ose persona të tjerë të kualifikuar, të cilët nuk janë deputetë të Kuvendit.
86. Ndërsa, përkundër faktit që konform paragrafit 2 të nenit 96 të Kushtetutës, numri i anëtarëve të Qeverisë përcaktohet me aktin e brendshëm të saj, paragrafët 3, 4 dhe 5 të po këtij neni të Kushtetutës përcaktojnë kriteret të veçanta për përbërjen e Qeverisë, që në mënyrë specifike i referohen përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë në Qeveri.
87. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se është kërkesë e qartë kushtetuese e paraparë në paragrafin 3 të nenit 96 të Kushtetutës që në Qeveri të jenë së paku një (1) ministër nga komuniteti Serb, dhe një (1) ministër nga komunitetet e tjera jo shumicë në Kosovë. Për më tepër, sipas paragrafit 3 të nenit 96, nëse Qeveria përbëhet nga më shumë se dymbëdhjetë ministra, ajo do të ketë edhe një ministër të “tretë”, i cili përfaqëson një nga komunitetet jo shumicë në Kosovë.
88. Andaj, ashtu siç theksohet edhe nga parashtruesit e kërkesës edhe nga Kryeministri, si përfaqësues i Qeverisë, Qeveria e zgjedhur sipas paragrafit 3 të

nenit 95 të Kushtetutës, duhet t'i plotësojë edhe kriteret e përcaktuara në nenin 96, paragrafin 3 të Kushtetutës dhe atë që në përbërjen e saj të jetë: një (1) ministër nga komuniteti Serb dhe një (1) ministër nga komunitetet e tjera jo shumicë në Kosovë, si dhe kriterin e përcaktuar në nenin 96, paragrafi 4 që në përbërjen e saj të ketë së paku dy (2) zëvendësministra nga komuniteti Serb i Kosovës dhe dy (2) zëvendësministra nga komunitete të tjera jo shumicë në Kosovë. Kjo ndarje e përfaqësimit në Qeveri është në përputhje edhe me përcaktimin e përfaqësimit në Kuvend të komuniteteve jo shumicë dhe terminologjinë e përdorur edhe në nenin 64 të Kushtetutës, i sqaruar më lart.

89. Për më tepër, nëse Qeveria përbëhet nga me tepër se dymbëdhjetë (12) ministri, atëherë caktohet edhe një ministër shtesë, përkatësisht ministri i "tretë" i cili përfaqëson një nga komunitetet jo shumicë në Qeveri si dhe një (1) zëvendësministër të tretë, i cili përfaqëson komunitetin Serb, dhe një (1) tjetër zëvendësministër, i cili përfaqëson një nga komunitetet e tjera jo shumicë në Kosovë. Gjykata vëren se sa i përket ministrit të "tretë" nga komunitetet jo shumicë, as paragrafi 3 i nenit 96 të Kushtetutës dhe as ndonjë dispozitë tjetër e Kushtetutës nuk përcakton nëse ministri i "tretë" duhet të jetë nga komuniteti Serb apo komunitetet e tjera jo shumicë. Gjuha e përdorur në paragrafin 3 të nenit 96 të Kushtetutës është e qartë kur flet për ministrin e "tretë", përkatësisht kjo dispozitë vetëm përcakton që ky i fundit përfaqëson *"një nga komunitetet jo shumicë në Kosovë"*. Gjykata vlerëson se ministri i "tretë" në Qeveri caktohet nga *"njëri nga"* komunitetet e përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 64 të Kushtetutës të përfaqësuara në Kuvend, që në këtë rast nënkupton: ose nga (i) komuniteti Serb, ose nga (ii) komunitetet e tjera jo shumicë, në Kuvend. Përmes kësaj plotësohet kriteri kushtetues që ministri i "tretë" të përfaqësojë komunitetet jo shumicë në Qeveri.
90. Andaj, Gjykata përfundimisht thekson se sipas Kushtetutës, caktimi i ministrit të "tretë" në Qeveri nga komunitetet jo shumicë është detyrim kushtetues në rast se Qeveria përbëhet nga më shumë se dymbëdhjetë (12) ministri. Megjithatë, Kushtetuta nuk specifikon detyrim kushtetues se cilin komunitet jo shumicë të përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 64 të Kushtetutës, e përfaqëson ministri i "tretë". Pra, kjo nuk nënkupton por as nuk e përjashton mundësinë që ministri i "tretë" në Qeveri nga komunitetet jo shumicë, të caktohet nga komuniteti Serb në Kosovë.
91. Gjykata vëren po ashtu se përfaqësimi i komuniteteve në Qeveri sipas paragrafit 3 të nenit 96 të Kushtetutës, është minimumi i përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë, në Qeverinë e Kosovës. Dispozitat relevante kushtetuese për përbërjen e Qeverisë mundësojnë që komunitetet jo shumicë të kenë përfaqësim më të madh në Qeveri, si pjesë e marrëveshjeve politike apo koalicioneve me partitë e tjera në Kuvend, që kanë fituar zgjedhjet dhe/apo që arrijnë të bëjnë shumicën e nevojshme prej të paktën gjashtëdhjetë e një (61) deputetëve, sipas paragrafit 3 të nenit 95 të Kushtetutës, për të formuar Qeverinë.
92. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se Qeveria e Kosovës e zgjedhur përmes vendimit të kontestuar përveç faktit që përbëhet edhe nga tre (3) ministra nga komuniteti jo shumicë, ka në përbërjen e saj edhe një zëvendëskryeministër nga komunitetet jo shumicë e cila ka ardhur, jo si rezultat i kërkesave kushtetuese,

por si rezultat i marrëveshjeve në mes të subjekteve politike në Kuvend, të cilat përfaqësojnë komunitetet jo shumicë. Kjo është në pajtueshmëri të plotë me atë se neni 96 i Kushtetutës parasheh përfaqësimin minimal të komuniteteve në Qeveri, dhe nuk kufizohet vetëm në atë që përcakton Kushtetuta si minimum të përfaqësimit, por lejon që subjektet politike, duke përfshirë ato të komuniteteve jo shumicë të mund të arrijnë marrëveshje politike për ndarjen e pozitave ministrore dhe për përfaqësim në Qeveri, përtej përfaqësimit minimal dhe pjesëmarrjes së garantuar. Në vazhdim, Gjykata do të elaborojë procedurën që duhet ndjekur lidhur me caktimin e ministrave që përfaqësojnë komunitetin jo shumicë në Qeveri.

(ii) Nëse caktimi i ministrave nga komunitetet jo shumicë, duke përfshirë caktimin e ministrit të “tretë” në Qeveri kërkon miratim formal nga të gjitha komunitetet jo shumicë

93. Marrë parasysh atë që Gjykata sqaroi më sipër se ministri i “tretë” në Qeveri nga komunitetet jo shumicë, nëse Qeveria i ka më shumë se dymbëdhjetë (12) ministri, mund të caktohet nga secili komunitet jo shumicë i përfaqësuar në Kuvend, në përputhje me ndarjen e vendeve në Kuvend sipas paragrafit 2 të nenit 64 të Kushtetutës, Gjykata në vazhdim do të elaborojë procedurën e zgjedhjes së ministrave që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Qeveri, dhe nëse për caktimin e ministrit të “tretë”, kërkohet miratim formal i të gjitha komuniteteve jo shumicë në Kuvend. Kjo procedurë është e përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 96 të Kushtetutës.
94. Paragrafi 5 i nenit 96 të Kushtetutë përcakton: *“Zgjedhja e këtyre ministrave [...] do të vendoset pas konsultimit me partitë, me koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë. Nëse caktohen kandidatë jashtë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, për këta ministra e zëvendësministra kërkohet miratimi formal i shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët u përkasin partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin në fjalë”*.
95. Gjykata vëren se sipas dispozitave të lartcekura të paragrafit 5 të nenit 96 të Kushtetutës caktimi i ministrave nga komunitetet jo shumicë mund të bëhet si në vijim:
- 1) kur për ministër caktohet një përfaqësues i komunitetit jo shumicë që është deputet i Kuvendit, e ku sipas paragrafit 5 të nenit 96 të Kushtetutës, përveç konsultimit me partitë, me koalicionet ose me grupet që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë, nuk kërkohet ndonjë aprovim formal nga deputetët e komuniteteve jo shumicë, me kushtin që të zgjedhet një (1) ministër nga Komuniteti Serb dhe një (1) ministër nga komunitetet e tjera jo shumicë në Kosovë. Ngjashëm, edhe sa i përket ministrit të “tretë” nga komunitetet jo shumicë, nëse Qeveria përbëhet nga më tepër se dymbëdhjetë (12) ministri, Kushtetuta nuk kërkon ndonjë miratim formal nga deputetët e komuniteteve jo shumicë, me kushtin që pas konsultimeve të caktohet një ministër që përfaqëson komunitetet jo shumicë, nëse ky i fundit është deputet i Kuvendit; dhe

- 2) kur për ministër caktohet një përfaqësues i komunitetit jo shumicë që nuk është deputet i Kuvendit e ku sipas paragrafit 5 të nenit 96 të Kushtetutës, përveç konsultimeve paraprake, kërkohet në mënyrë specifike që ai kandidat të marrë miratimin formal të shumicës së deputetëve që përfaqësojnë komunitetin në fjalë. Në këtë aspekt, kjo procedurë zhvillohet si në rastet kur zgjedhet një (1) ministër nga Komuniteti Serb, ashtu, dhe një (1) ministër nga ndonjë komunitet tjetër jo shumicë në Kosovë, të cilët detyrimisht duhet të marrin votat e shumicës së deputetëve të komunitetit “tjetër jo shumicë”. Ngjashëm, një miratim formal nga komuniteti “në fjalë” kërkohet edhe në rastet kur për ministër të “tretë” caktohet një person që i përket komunitetit jo shumicë në Kosovë, komunitetit Serb apo komunitetit tjetër jo shumicë, por nuk është deputet i Kuvendit të Kosovës.
96. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se Kushtetuta, përkatësisht paragrafi 5 i nenit 96 të saj, lidhur me miratimin formal të kandidatëve nga komunitetet jo shumicë i referohet partisë, koalicioneve ose grupeve “që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë”, por duke vënë theksin në fund të këtij paragrafi në “komunitetin në fjalë”.
97. Në këtë kontekst, Gjykata gjen se (i) lidhur me Ministrin që përfaqëson komunitetin Serb, kërkohet konsultimi me/miratimi nga (varësisht a është kandidati deputet apo jo) partitë, koalicionet ose me grupet që përfaqësojnë komunitetin Serb, në Kuvend. Në këtë aspekt, fjala është për dhjetë (10) deputetë që mbajnë vendet e garantuara për partitë, koalicionet, nismat qytetare, nga komuniteti Serb, sipas nenit 64, paragrafit 2, nënparagrafit 1 të Kushtetutës, elaboruar më lart. Ngjashëm edhe për (ii) caktimin e 1 (një) Ministri nga “komunitetet e tjera” jo shumicë, me ç’rast kandidati për këtë pozitë duhet të konsultohet me/marrë miratimin nga (varësisht a është kandidati deputet apo jo) partitë, koalicionet ose me grupet që përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë në Kuvend. Kjo i referohet dhjetë (10) deputetëve që mbajnë vendet e garantuara për partitë, koalicionet, nismat qytetare, dhe atë komunitetet Rom; Ashkali; Egjiptian, Boshnjak, Turk dhe Goran, siç janë përcaktuar në nenin 64, paragrafi 2, nënparagrafi 2.
98. Ndërsa, për caktimin e ministrit të “tretë”, kandidati për Kryeministër, konform paragrafit 3 të nenit 96, ka mundësi, pas konsultimit/miratimit nga (varësisht nëse kandidati është deputet apo jo) të caktojë një kandidat që i përket “njërit nga komunitetet jo shumicë” të përfaqësuar në Kuvend. Pra në këtë rast, ose nga (i) partitë, koalicionet a grupet “që përfaqësojnë komunitetin Serb” (si tërësi); ose nga (ii) partitë, koalicionet ose grupet “që përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë” (si tërësi), sipas ndarjes së paraparë në nenin 64 të Kushtetutës.
99. Andaj, Gjykata vlerëson se kandidati për Kryeministër detyrohet që për caktimin e ministrit nga komuniteti jo serb të konsultohet/të merr miratimin vetëm nga komuniteti serb, ndërsa për caktimin e ministrit nga komunitetet tjera jo shumicë duhet të konsultohet/të merr miratimin (varësisht nëse kandidati për ministër është deputet i Kuvendit apo jo) vetëm nga komunitetet tjera jo shumicë.

100. Për dallim nga kjo, për caktimin e ministrit të “tretë” në Qeveri, në këtë rast kandidati për Kryeministër përcaktohet se nga cili komunitet “në fjalë”, pra “komuniteti Serb” apo komuniteti “tjetër jo shumicë” dëshiron të emërojë ministrin e tretë. Dhe në këtë rast kandidati për Kryeministër (i) konsultohet me komunitetin “në fjalë”; ose (ii) merr miratimin e tyre (nëse kandidati nuk është deputet i Kuvendit), pra: ose (i) komunitetin Serb; ose (ii) komunitetet e tjera jo shumicë.
101. Ky interpretim përputhet edhe me qëndrimin e vet parashtruesve të kërkesës se *“Përfaqësimi i rezervuar i komuniteteve jo shumicë në Qeveri përbën të ashtuquajturin parim „të qeverisë së gjerë“ në kuptim të multiethnicitetit, dhe është një kusht kryesor i demokracisë konsociacionale [...]”*
102. Rrjedhimisht, dhe bazuar në të lartcekurat, Gjykata vlerëson se as neni 96 e as ndonjë dispozitë tjetër e Kushtetutës, nuk kërkon miratim formal për ministrin e “tretë” nga të gjithë deputetët që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë, në rast se ministri i “tretë” që caktohet nga radhët e komuniteteve jo shumicë, është deputet i Kuvendit.
103. Miratimi formal i ministrave nga komuniteti jo shumicë “në fjalë”, nga komuniteti Serb ose nga komunitetet e tjera jo shumicë, kërkohet vetëm nëse caktohet një kandidat nga komuniteti jo shumicë në fjalë që nuk është deputet i Kuvendit, dhe kjo ndarje është bërë qartë në Kushtetutë. Nëse do të kërkohej një miratim formal edhe për kandidatët që janë deputetë të Kuvendit, atëherë ndarja e bërë në Kushtetutë lidhur me atë nëse një person është deputet i Kuvendit apo jo, për t’u caktuar ministër që përfaqëson komunitetet jo shumicë, nuk do të kishte kuptim.

(iii) Nëse kriteret e lartcekura janë zbatuar në rastin e tanishëm

104. Sa i përket rastit konkret, Gjykata vëren se më 14 shkurt 2021, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme për Kuvend. Ndërsa pas numërimit të votave, më 13 mars 2021, KQZ certifikoi rezultatet e zgjedhjeve me ç’rast, LVV ishte partia fituese me pesëdhjetë e tetë (58) deputetë ndërsa njëzet (20) vende në Kuvend të cila janë të garantuara më Kushtetutë ishin ndarë për komunitetin jo shumicë, me ç’rast, Lista Serbe, që ishte deklaruar se përfaqëson komuniteti Serb në Kosovë kishte marrë dhjetë (10) deputetë, ndërsa dhjetë (10) vende të tjera ishin ndarë për komunitete të tjera jo shumicë në Kosovë, konform nenit 64 të Kushtetutës.
105. Gjykata vëren po ashtu se pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve nga KQZ, Kryetari i LVV-së si parti fituese e zgjedhjeve kishte filluar konsultimet me subjektet politike në Kosovë duke përfshirë edhe ato të komuniteteve jo shumicë. Në këtë kontekst, më 16 mars 2021, ishte mbajtur një takim në mes të përfaqësuesve të LVV-së dhe atyre të Listës Serbe. Takime të ngjashme ishin mbajtur edhe me përfaqësuesit e subjekteve politike të komuniteteve të tjera jo shumicë në Kosovë. Për më tepër, më 21 mars 2021, respektivisht më 22 mars 2021 kishin ndodhur shkëmbime letrash mes z. Albin Kurti, në cilësinë e tij si Kryetar i LVV-së dhe kandidat për Kryeministër dhe z. Goran Rakić, në cilësinë e

këtij të fundit si Kryetar i Listës Serbe, lidhur me caktimin e përfaqësuesve të komunitetit Serb në Qeveri.

106. Më 22 mars 2021, U.d Presidenti nxori Dekretin Nr.61/2021 me të cilin *“Z. Albin Kurti i propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës.”* Po atë ditë, përmes vendimit të kontestuar, nr. 08/V-005, Kuvendi me 67 vota “për”, 30 “kundër” dhe asnjë abstenim zgjodhi Qeverinë e Republikës së Kosovës, të përbërë nga pesëmbëdhjetë (15) ministri. Tri (3) nga pozitat ministrore në Qeveri dhe një (1) pozitë e Zëvendës Kryeministrit, u ishin caktuar përfaqësuesve nga komuniteti jo shumicë dhe atë: a) z. Goran Rakić, Ministër i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, nga komuniteti Serb, i cili pasi nuk kishte qenë deputet i Kuvendit, paraprakisht ishte votuar dhe kishte marrë 10 nga 10 votat e përfaqësuesve të komunitetit Serb në Kuvend, konform paragrafit 5 të nenit 96 të Kushtetutës; b) Fikrim Damka, Ministër i Ministrisë për Zhvillim Rajonal, nga komuniteti tjetër jo shumicë, në këtë rast komuniteti turk; dhe c) Elbert Krasniqi, Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, nga komuniteti jo shumicë, në këtë rast nga komuniteti Egjiptian në Kosovë, si ministër “i tretë” në Qeveri. Ndërsa, d) Emilija Redžepi, nga komuniteti jo shumicë, në këtë rast nga komuniteti Boshnjak në Kosovë, Zëvendëskryeministre për çështje të pakicave dhe të drejtat e njeriut.
107. Gjykata rikujton se kontestuese para Gjykatës është mënyra dhe procedura lidhur me caktimin e ministrit “të tretë” në Qeveri. Gjykata ka konstatuar më lart se Kushtetuta nuk kërkon miratim të propozimit të ministrit të “tretë” nga deputetët që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë, në rast se ministri i “tretë” nga komunitetet jo shumicë, është deputet i Kuvendit.
108. Në rastin konkret, ministri i “tretë” nga komunitetet jo shumicë, Elbert Krasniqi, lidhur me të cilin parashtruesit e kërkesës ankohen para Gjykatës, ka qenë deputet i Kuvendit i zgjedhur në zgjedhjet e 14 shkurtit 2021, i deklaruar se përfaqëson një nga komuniteti tjetër jo shumicë në Kuvend, në kuptim të nenit 64 të Kushtetutës, dhe i cili është caktuar për këtë pozitë pas konsultimeve me përfaqësuesit e komuniteteve të tjera jo shumicë në Kuvend, para votimit të Qeverisë.
109. Në këtë kontekst, komunitetet e tjera jo shumicë as nuk kanë paraqitur ndonjë pretendim se ata nuk janë konsultuar lidhur me caktimin e këtij të fundit si ministër, edhe pse atyre u ishte mundësuar nga Gjykata që të paraqesin komentet e tyre lidhur me kërkesën e dorëzuar nga parashtruesit e kërkesës. As parashtruesit e kërkesës nuk e kontestojnë faktin që ka pasur diskutime lidhur me caktimin e ministrave nga komunitetet jo shumicë para zgjedhjes së Qeverisë, por pretendojnë se ministri i “tretë” është dashtë të ketë miratimin e shumicës së të gjithë njëzet (20) deputetëve të komuniteteve jo shumicë.
110. Gjykata po ashtu rikujton se parashtruesit e kërkesës argumentin e tyre për zgjedhjen e ministrit të tretë e ndërlidhin duke bërë krahasime me pozitat e tjera në Kuvend në të cilat përfaqësohen komunitetet jo shumicë, si dhe me pozita të tjera që zgjedhen nga Kuvendi, ku përfaqësohen komunitetet jo shumicë. Shembull për këtë ata marrin zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit që

propozohet nga komuniteti Serb, por edhe emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

111. Megjithatë, rastet kur kërkohet miratimi i shumicës së të gjithë përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë, pra të 20 deputetëve të komunitetin jo shumicë (komunitetit Serb dhe komuniteteve të tjera jo shumicë, si tërësi), janë të përcaktuara në mënyrë shprehimore në Kushtetutë. Në këtë kontekst, sipas paragrafit 3 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese], sa i përket propozimit të dy (2) gjyqtarëve, nga nëntë (9) sa ka Gjykata Kushtetuese, qëndron fakti se Vendimi për të propozuar dy (2) gjyqtarët e tjerë, merret me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, por që mund të bëhet vetëm pas dhënies së pëlqimit të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet që janë të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. Por, siç u theksua, në këtë rast, një kërkesë e tillë parashihet në mënyrë shprehimore në paragrafin 3 të nenit 114 të Kushtetutës.
112. Për dallim prej rastit të lartcekur, në rastin e zgjedhjes së anëtarëve të Qeverisë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë, një kërkesë e tillë kushtetuese për votimin e anëtarëve të Qeverisë nga të gjitha komunitetet jo shumicë nuk parashihet në Kushtetutë pasi neni 96 paragrafi 5 i Kushtetutës vënë theksin në miratimin nga komuniteti “në fjalë”, dhe jo nga të gjitha komunitetet jo shumicë. Dhe një kërkesë e tillë edhe është zbatuar në rastin e miratimit të propozimit të Ministrit Goran Rakić, ministër nga komuniteti Serb, i cili, pasi nuk ishte deputet i Kuvendit, sipas transkriptit të Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Kuvendit, të 22 marsit 2021, ishte votuar fillimisht nga deputetët që përfaqësojnë komunitetin Serb dhe pastaj ishte përfshirë për votim në përbërjen e plotë të Qeverisë. Sikur qëllimi i kushtetutëbërësit të ishte që ministri i “tretë” të caktohet pas miratimit të shumicës së deputetëve që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kuvend, kjo do të precizohej në dispozitat relevante të Kushtetutës, njësoj sikurse që u shpjegua më lart, me rastin e zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.
113. Andaj, bazuar në atë që u tha më sipër, Gjykata konsideron se pretendimi i parashtruesve të kërkesës për shkelje të paragrafëve 3 dhe 5 të nenit 96 të Kushtetutës, me rastin e caktimit të ministrit të “tretë” në Qeveri, nuk është i bazuar.
114. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar është në pajtueshmëri me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës.

Lidhur me kërkesën për mbajtje të seancës dëgjimore

115. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës gjithashtu kanë kërkuar nga Gjykata që të mbajë seancë dëgjimore në të cilën do të ftonte të gjithë deputetët që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kosovë që të përcaktojnë çështjet që ndërliken me përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë në Qeveri.

116. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në bazë të paragrafit (1) të rregullit 42 [E drejta në dëgjim dhe heqja dorë] të Rregullores së punës: *“Vetëm kërkesat e përcaktuara si të pranueshme mund të dëgjohen para Gjykatës, përveç nëse Gjykata, me shumicë votash, vendos ndryshe pas një arsyetimi të mirë”*; ndërsa, në bazë të paragrafi (2) të po të njëjtit rregull: *“Gjykata mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit”*.
117. Gjykata thekson se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës është i karakterit diskrecional. Si i tillë, ai rregull vetëm parasheh mundësinë që Gjykata të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rastet kur ajo beson se është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit. Pra, Gjykata nuk është e obliguar të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se ajo konsideron se faktet ekzistuese në shkresat e lëndës mjaftojnë, përtej çdo dyshimi, për të arritur tek një vendim merititor lidhur me rastin që është në shqyrtim (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KO43/19, parashtruese: *Albulena Haxhiu, Driton Selmanaj dhe tridhjetë deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 13 qershorit 2019, paragrafi 116; shih gjithashtu rastin, KI34/17, parashtruese *Valdete Daka*, Aktgjykim i 1 qershorit 2017, paragrafët 108-110).
118. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata nuk konsideron se ka ndonjë paqartësi rreth “provave apo ligjit” dhe për këtë arsye nuk e sheh të nevojshme mbajtjen e seancës dëgjimore. Dokumentet dhe shkresat të cilat janë pjesë e dosjes së rastit KO61/21 janë të mjaftueshme për të vendosur këtë rast.
119. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesve të kërkesës për mbajtje të seancës dëgjimore refuzohet si e pabazuar.

Lidhur me kërkesën për masë të përkohshme lidhur me vendimin e kontestuar

120. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës, gjithashtu kërkojnë nga Gjykata që të nxjerrë vendim për vendosjen e masës së përkohshme *“me të cilën do ta vendoste në gjendje qetësie pozitive e ministrit i cili u emërua Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal - Elbert Krasniqi sepse nuk e ka mbështetjen e (11) njëmbëdhjetë deputetëve që përbën shumicën e (20) njëzet deputetëve të cilët përfaqësojnë komunitetet jo shumicë”*.
121. Gjykata më sipër ka konkluduar se vendimi i kontestuar është në pajtueshmëri me nenin 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës.
122. Prandaj, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 27 [Masat e Përkohshme] të Ligjit dhe me rregullin 57 [Vendimi për masë të përkohshme] të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme, është pa objekt shqyrtimi dhe, si e tillë, refuzohet.

Përfundim

123. Çështja kryesore që ngërthen ky rast ndërlihet me mënyrën e caktimit të ministrave që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Qeveri. Para Gjykatës, nuk ishte kontestuese mënyra e caktimit të një (1) ministri që caktohet detyrimisht nga komuniteti Serb; ose një (1) ministri që caktohet detyrimisht nga komunitetet e tjera jo shumicë, por caktimi i ministrit të “tretë” në Qeveri nga komunitetet jo shumicë, që është detyrim kushtetues në rast se Qeveria përbëhet nga më tepër se dymbëdhjetë (12) ministra. Lidhur me këtë, parashtruesit e kërkesës pretenduan se për caktimin e ministrit të “tretë” në Qeveri është i nevojshëm konsultimi/miratimi nga shumica e të gjithë deputetëve që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kuvend, përkatësisht nga të paktën njëmbëdhjetë (11) nga njëzet (20) deputetët që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë.
124. Gjykata Kushtetuese theksoi se, për qëllime të kushtetutshmërisë së përbërjes së Qeverisë, bazuar në nenin 96 të Kushtetutës, në Qeveri duhet të jenë së paku një (1) ministër nga komuniteti Serb dhe një (1) ministër nga komunitetet e tjera jo shumicë. Mënyra e zgjedhjes së këtyre ministrave dallon varësisht nëse kandidati i propozuar për ministër është deputet i Kuvendit ose jo. Për caktimin e një kandidati për ministër nga radhët e deputetëve të Kuvendit, është i nevojshëm konsultimi me partitë, koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë. Ndërsa, për caktimin e një kandidati për ministër jashtë radhëve të deputetëve të Kuvendit, është i nevojshëm miratimi formal i shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët u përkasin partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin në fjalë. Gjykata Kushtetuese gjithashtu theksoi se, Kushtetuta përcakton që në rast se përbërja e një Qeverie ka më shumë se dymbëdhjetë (12) ministra, Qeveria duhet të ketë edhe një ministër të tretë, *“i cili përfaqëson një nga komunitetet jo shumicë në Kosovë”*. Gjykata tutje theksoi se, për sa i përket ministrit të tretë, Kushtetuta i mundëson diskrecion mandatarit për Kryeministër përkitazi me radhët e komuniteteve përkatëse, nga të cilët mund të zgjedhet një ministër i tretë, duke mos përcaktuar detyrimisht që ky ministër duhet të propozohet/miratohet nga deputetët që përfaqësojnë komunitetin Serb ose nga deputetët që përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë, por duke kërkuar që të ndiqet procedura e njëjtë përkatësisht konsultimi/miratimi i *“komunitetit në fjalë”*, varësisht nëse kandidati përkatës është deputet i Kuvendit ose jo.
125. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata theksoi se ministri i “tretë” nga komunitetet jo shumicë, përkatësisht Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, ishte deputet i Kuvendit i zgjedhur në zgjedhjet e 14 shkurtit 2021, i deklaruar se përfaqëson një nga komunitetet e tjera jo shumicë në Kuvend në kuptim të nenit 64 [Struktura e Kuvendit] të Kushtetutës dhe i cili është propozuar për këtë pozitë në konsultim me deputetët që përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë në Kuvend. Duke marrë parasysh që kandidati përkatës ishte deputet i zgjedhur i Kuvendit, miratimi formal nga komuniteti në fjalë nuk është detyrim kushtetues, ndërsa para Gjykatës nuk kishte asnjë pretendim që deputetët që përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë nuk ishin konsultuar në propozimin e këtij kandidati për ministër, përkundër faktit

që Gjykata u kishte mundësuar që të paraqesin komentet e tyre lidhur me kërkesën e dorëzuar nga parashtruesit e kërkesës.

126. Gjykata përfundimisht sqaroi që bazuar në nenin 96 të Kushtetutës, i detyrueshëm është konsultimi me ose miratimi i deputetëve që përfaqësojnë “komunitetin në fjalë”, përkatësisht deputetët që përfaqësojnë komunitetin Serb ose që përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë, varësisht nëse kandidati përkatës është deputet i Kuvendit ose jo, dhe jo shumica e të gjithë deputetëve që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë. Në rrethanat e rastit konkret, kandidati i propozuar për ministër ishte deputet i Kuvendit dhe për pasojë miratimi formal i tij nuk ishte detyrim kushtetues, ndërsa para Gjykatës nuk kishte asnjë pretendim që detyrimi për konsultimin e “komunitetit në fjalë” nuk ishte shteruar. Prandaj, **Gjykata konstatoi që, Vendimi i kontestuar i Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e Qeverisë nuk është nxjerrë në kundërshtim me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 të Kushtetutës.**

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113, paragrafi 5 të Kushtetutës, neneve 27, 42 dhe 43 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullave 42, 57, 59 (1) dhe 74 të Rregullores së punës, më 24 shtator 2021;

VENDOS

- I. TË SHPALLË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, me shumicë votash, që procedura për nxjerrjen e Vendimit nr.08/V-005 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 22 marsit 2021, është zhvilluar në pajtueshmëri me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës;
- III. TË REFUZOJË, njëzëri, kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme;
- IV. TË REFUZOJË, me shumicë votash, kërkesën për mbajtjen e seancës dëgjimore;
- V. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- VI. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20, paragrafi 4 të Ligjit; dhe
- VII. TË SHPALLË që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani